



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 8698 / Prot. 31

Divjakë më 27/08 / 2025

RAPORT VENDIMMARRJE

I KOMISIONIT TË SHËNDETËSISË, MIRËQËNIES SOCIALE DHE BARAZISË GJINORE
Komisioni i shëndetësisë, mirëqënies sociale dhe barazisë gjinore, i Këshillit Bashkiak Divjakë, në mbledhjen e tij të radhës, shqyrtoi materialin e paraqitur nga Bashkia Divjakë lidhur me miratimin e Planit Social të Bashkisë Divjakë për periudhën përkatëse.

Baza Ligjore Ligji nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; VKM nr. 710, datë 29.12.2017, “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”; Udhëzime dhe akte nënligjore të tjera në fuqi, që rregullojnë planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia e Planit Social; Plani Social i Bashkisë Divjakë 2025-2028, është një dokument strategjik që përcakton nevojat, prioritetet dhe masat konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale për komunitetin. Ai ka si qëllim: Përmirësimin e cilësisë së jetës së grupeve në nevojë; Rritjen e përfshirjes sociale; Mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, të moshuarve, grave dhe grupeve vulnerabël.

Diskutimet e Komisionit; Gjatë shqyrtimit të materialit, anëtarët e Komisionit vlerësuan se Plani Social është në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjitë kombëtare për përfshirjen sociale. U theksua rëndësia e organizimit të degjesave publike si dhe zbatimit të masave të planifikuara dhe sigurimi i burimeve financiare e njerëzore për realizimin e tyre.

Vendimmarrja; Pas diskutimeve dhe shqyrtimit të materialit të paraqitur, Komisioni i shëndetësisë, mirëqënies sociale dhe barazisë gjinore, Propozon miratimin e Planit social 2025-2028, Rekomandon, ndjekjen e zbatimit të masave të planifikuara dhe raportimin periodik para Këshillit Bashkiak mbi ecurinë e zbatimit të këtij Plani.

KOMISIONI I SHËNDETËSISË, I MIRËQËNIES SOCIALE DHE BARAZISË GJINORE

1. Ardian Vodo (kryetar)

2. Majlinda Xharo (zv.kryetar)

3. Elda Sinani (sekretar)

4. Alketa Çanaku (anëtar)

5. Bido Dermysi (anëtar)

